



RÖFIX PP 301 HYDRO LF

Forcues universal dhe Astar boje

Udhëzime teknike dhe ligjore:


Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Fushat e përdorimit:

Astar special universal, i pa pigmentuar, transparent për bazamente jo të qëndrueshme. Për rritjen e qëndrueshmërisë së bazamentit dhe unifikimin e sipërfaqeve të reja me ato të vjetra. Si astar universal i përshkueshëm ndaj avujve, për bojrat si vijojnë, me dispersion, me rrëshirë silikoni dhe bojë me dispersion silikoni. Për brenda dhe jashtë mbi bazamente minerale dhe organike, si suva të vjetër me rrëshirë silikoni ose rezinë silikoni dhe sistemet e vjetra të termoizolimit.

Karakteristikat:

- Sipërfaqet me bazë organike dhe minerale përmirësojnë krijimin e sipërfaqeve organikeme aftësi të lartë mbajtëse.
- Pa ngjyrë, transparent
- Nivelon aftësinë thithëse të bazamentit
- Përmirëson ngjitjen
- Pa përbërje holluesi ose nafti.

Përpunimi:

Të dhëna teknike		
SAP-Art. Nr.:	2000148697	140979
NAV-Art. Nr.:	110339	140979
Informacion mbi produktin	Mund të përdorni dhe RÖFIX Hydrosol	
Lloji i paketimit		
Njesi per palete	60 Nj./Pal	84 Nj./Pal
Sasi për njësi	10 l/Nj.	5 l/Nj.
Ngjyra	transparente	
Konsumi	ca. 0,2 l/m ²	
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.	
Dëndësia	1,1 kg/l	
Vlera e pH	ca. 8	
Këshilla për paketimin	Në kanistër plastik të riciklueshëm	
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 25 °C	

Baza e materialit:

- Lidhës: Polymer-Dispersion
- Përbërës: Produkte konservimi

Kushtet e punimit:

Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C. Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.

Bazamenti:

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, me aftësi mbajtëse si dhe pa papastërti si p.sh. pluhur, alga, blözë, kripra etj. .



RÖFIX PP 301 HYDRO LF

Forcues universal dhe Astar boje

Bazamenti Trajtimi paraprak:

Suva mbushëse të grupit IV dhe V: Suva mbushëse me bazë gipsi, gips-gëlqere dhe suvatë anhidride: Pastrojeni sipërfaqen nga papastërtitë dhe shtresat e lirshme. Produktin përshtateni sipas aftësive thithëse të bazamentit. Gjatë aplikimit produkti duhet të thithet nga bazamenti. Një-ose dy duar lyerje.

Suva për grupet e llaçërave Ia dhe Ib: me bazë gëlqere: Mos e përdorni në këto bazamente
Suva mbushëse e grupit të llaçërave II dhe III: me bazë gëlqere / çimento: Pastroni sipërfaqen. Bëni përzjerjen e duhur të produktit sipas aftësive thithëse të bazamentit. Gjatë përdorimit produkti duhet të thithet nga bazamenti. Sipërfaqen lyejeni 1-2 herë.

Shtresa (Alt-) dhe lyerje të forta (Alt-) me bazë dispersioni: Pastroni sipërfaqen. Bëni përzjerjen e duhur të produktit sipas aftësive thithëse të bazamentit. Gjatë përdorimit produkti duhet të thithet nga bazamenti. Sipërfaqen lyejeni 1-2 herë.

Shtresa (Alt-) dhe lyerje të forta (Alt-) me bazë silikati: Pastroni sipërfaqen. Bëni përzjerjen e duhur të produktit sipas aftësive thithëse të bazamentit. Gjatë përdorimit produkti duhet të thithet nga bazamenti. Sipërfaqen lyejeni 1-2 herë.

Shtresa (Alt-) dhe lyerje të forta (Alt-) me bazë silikon-silikat: Pastroni sipërfaqen. Bëni përzjerjen e duhur të produktit sipas aftësive thithëse të bazamentit. Gjatë përdorimit produkti duhet të thithet nga bazamenti. Sipërfaqen lyejeni 1-2 herë.

Pllaka karton gipsi, pllaka gipsi, pllaka të plota gipsi: Pastroni sipërfaqen. Bëni përzjerjen e duhur të produktit sipas aftësive thithëse të bazamentit. Gjatë përdorimit produkti duhet të thithet nga bazamenti. Sipërfaqen lyejeni 1-2 herë.

Suva mbushëse të të gjitha llojeve të llaçërave (gëlqere, gëlqere- çimento, çimento, gips, gips- gëlqere): Shtresat ose sipërfaqet të cilat edhe pas parapërgatitjes së bazamentit me astarët/fortësuesit e këshilluar si psh. RÖFIX PP 201 SILICA LF, PP 401 SILCO LF, PP 301 HYDRO LF ose PP 307 ISO LF nuk kanë arritur ende fortësinë mbajtëse, duhen (Këshillë: prerja e kryqezuar sipas EN 2409), të prishen në mënyrë mekanike.

Bazamenti-Trajtimi paraprak:

Shtresat e bojrave të vjetra të cara dhe të dala ngjyrë duhen larguar mekanikisht. Bajrat e vajit, llakut dhe ato që kanë tendencë të shpërndahen duhet të hiqen me një produkt që heq bojen. Mbetjet e tapicerisë dhe ngjitesave largohen me uje të ngrohtë.

Përgatitja:

Astarë/fortësues duhet të hollohen me produktin e duhur duke u përgatitur sipas aftësive thithëse të bazamentit. Nuk duhet të krijohen shtresa të lëmuara/me shkëlqim. Përdorimi si astar: astari duhet të përthithet nga bazamenti. Nuk duhet të ketë shtresa me shkëlqim. Hollojeni me ujë në raportin 1:3- 1:4

Përpunimi:

Shtrimi vijon i plotë, i njëtrajtshëm, duke mbuluar gjithshka, me anë të një furçe, apo rruli. Aplikimi me makinë kryhet i njëtrajtshëm me anë të një pajisje sprucuese të përshtatshme

Këshilla në rast reziku:

Informacione më të detajuara për sigurinë mund të lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur të lexoni me kujdes këto skeda.

Këshilla për përpunimin:

Koha e tharjes para aplikimit të shtresës së fundit, rreth 24 orë (sipas temperaturës dhe kushtet atmosferike). Duhet pasur kujdes që pas tharjes të mos ketë sipërfaqe të lyera të shndritshme. Krijoni hapësirën e provës. Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Pastrojeni me kujdes veglat e punës pas përdorimit.

Magazinimi:

Magazinojeni në vende të freskëta, të mbrojtur nga ngrica dhe të mbyllura mirë. Koha e magazinimit min. 12 muaj.

Deklaratë:





ROFIX PP 301 HYDRO LF

Forcues universal dhe Astar boje

Këshilla të përgjithshme:

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme.

Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkohen edhe pranë filjaleve rajonale në vënd.

Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme.

Vlerat teknike janë bazuar tek produktet bazë. Gjatë pigmentimit ose ngjyrosjes, janë të mundshme edhe devijime nga të dhënat teknike. Në dhënien e vlerave bëhet fjalë për vlera mesatare. Meqënëse produktet tona përbëhen nga materiale natyrore, mund të ndodhë që në një ngarkesë të kemi edhe devijime minimale të vlerave. Për veshjen e sipërfaqeve, të cilat këtu nuk janë përshkruar, do të ishte i nevojshëm një marrje mendimi nga ana jonë. Në rast porosie plotësuese ose në lidhje me katalogun e ngjyrave, pigmentet mund të ndryshojnë minimalisht, prandaj dhe në kantiere duhet të bëni si fillim një mostër për krahasim. Të dhënat në lidhje me kohën e pritjes-veprimit janë percaktuar në kushtet e laboratorit (+20 °C/65 % Lageshtirë/e mbetur) dhe sipas kushteve të kantierit mund të ndryshojnë.

Të dhënat janë pa rrezik për vërtetësinë dhe plotësinë dhe pa detyrime për kërkesa të çdo natyre, si dhe të rezultatave të klientit. Janë të vlefshme edhe Skedat Teknike të produkteve ROFIX, të cilat janë të përmëndura edhe në këtë skedë teknike.

Shërbimi ynë i konsulencës teknike është në dispozicionin tuaj në rast pyetjesh lidhur me përdorimin, përpunimin si dhe demonstrimin e produkteve tona.

Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona.